VENDIM
Nr. 192, datë 2.12.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "KROI MBRET ENERGJI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 113/1 prot., datë 25.11.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 634 prot., datë 11.10.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 7.11.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 32/47, datë 8.11.2019, dhe, në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k.
- Me shkresën nr. 634/1 prot., datë 12.11.2019, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 634/2 prot., datë 20.11.2019, shoqëria "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Aplikimi i shoqërisë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Kroi Mbret Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi